

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	PRISHTINA 
---	---	--

Arttari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/ A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.04.2023 parashtruar nga Operatori Ekonomik: BENI shpk., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1, Autoriteti Publik – Komuna e Prishtinës me datë: 12.04.2023 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet në tërësi kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: BENI shpk e parashtruar me datë: 12.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës**, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1, kundër *Njoftimit mbi Vendimin e AK -së*, të datës 07.04.2023 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, në bazë të nenit 108/ A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.
2. Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për të vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës**, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Arsyetim

Autoriteti Publik me datë: 07.04.2023 ka bërë Njoftimin mbi Vendimin në web-faqe të KRPP-së duke respektuar nenin 16 par.2 shkronja L të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022..

Operatori Ekonomik në bazë të nenin 108/A ka ushtruar mjetin juridik kërkesë për rishqytim me datë: 12.04.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës: 07.04.2023, i cili ka paraqitur pretendimet ankimore si në vijim:

1.

Autoriteti Kontraktues **Kuvendi i Komunes se Prishtines** me datën 07.04.2023 ka bere publikimin e njoftimit B58-Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku, padrejtësisht na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit, pasi qe i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e AK te vendosura ne NJK dhe DT ku si arsye te eliminimit ka cekur se: “I mungon deklarata mbi Operimin (shpeshtësia e pastrimit të sipërfaqeve sipas paramasës) min. I herë max 3 herë), poashtu, i mungon vendosja e çmimeve në pozicione në përshkrim të çmimeve”.

Kjo arsye e eliminimit eshte e kunderligjshme, pasi qe ne NJK dhe DT nuk eshte kerkuar nje kerkese e tille dhe AK nuk ka te drejte qe ta eliminoj nje OE per nje kerkese te cilen nuk e ka cekur ne NJK dhe DT.

AK na ka eliminuar ne kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-së ku thuhet: *“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*

Neve mund te ju sigurojme me dhjetra vendime te OSHP-se ku nuk ka qene kerkese d osjes se tenderit dhe OSHP nuk ka lejuar qe te eliminohet nje OE nese AK nuk e ka parapare si kerkese per vleresim. Si shembull po ju japim vendimin me PSH. nr. 741/22 ku thuhet si me poshtë:

Duhet theksuar se parimet kryesore të procedurës së vlerësimit, sipas LPP, ndër të tjera janë që: [...] Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kriterëve të specifikuar të dhënies së kontratës dhe se vetëm kërkesat dhe kriteret e dhënies së kontratës të specifikuar në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdoren si bazë për vlerësim.

Gjithashtu arsye tjeter e eliminimit se kinse nuk kemi vendosur cmime ne pozicione tek pershrimi i cmimeve eshte e pa vertete pasi qe neve e kemi plotesuar komplet dokumentin e AK-se me me mbishkrimin e dokumentit “ Përshkrimi i Çmimit (7)” ne formatin excel. Neve kete dokument e kemi ngarkuar ne e-prokurim konform udhezimeve te publikuara nga krpp gjithashtu neve kemi plotesuar ne tabelen e cmimeve dhe ne platforemen e e-prokurimit kur e kemi dorezuar oferten. Pra nuk eshte faji i jone nese AK ka ndonje problem me kompjuteret e tyre neve mund te vim ne AK dhe nga llogaria jone te cilen e kemi ngarkuar dokumentin mund ta shkarkojme dhe shihet qarte se eshte i plotesuar dhe i kompletuar ne te gjitha pozicionet ashtu siq ka qene kerkese e AK-se.

Neve ju kemi përmbajte kërkesave te AK-se te vendosura ne NJK dhe DT andaj AK kundërligjshëm na ka eliminuar nga ky aktivitet te prokurimit.

2.

AK ne menyre te pa pergjegjshme ka rekomanduar per kontrate GOE te pa pergjegjeshem i cili nuk i ka plotesuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.

GOE i rekomanduar per kontrate ka vene nen lajthitje AK-ne pasi qe tek llogaritja e cmimeve nuk i ka llogaritur siq duhet por e ka mshefur cmimin, ku nese i llogaritet cmimi total atehere diferenca e cmimit eshte mbi 2% nga cmimi i dhene ne hapje te tenderit

PARAMASA: SHËRBIMET E PASTRIMIT TË OBJEKTEVE , ARSIMORE (HAPASIRAT E BRENDSHME DHE TË JASHTME) KONTRATË KORNIZË

I. Paramasa e sipërfaqeve të mbrendshme						
	Emri i objekteve Institucionale	Njësia	Sasia	Cmimi Njësia me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 15 muaj
1	Shkollën Abdyl Frasheri	m ²	2,850.00	0.39	1,111.50	16,672.50
2	Shkollja 7 Shtatori	m ²	1,000.00	0.39	390.00	5,850.00
3	Shkollja Prenk Jakova	m ²	2,540.00	0.39	990.60	14,859.00
4	Shkollja Eqrem Qabej	m ²	6,778.40	0.39	2,643.58	39,653.64
5	Shkollja Hadrie Kadej Prishtina	m ²	5,400.00	0.39	2,106.00	31,590.00
6	Shkollja Gjimesi Matematikor	m ²	4,550.00	0.39	1,774.50	26,617.50
7	Shkollja 28 Nentori	m ²	1,500.00	0.39	585.00	8,775.00
8	Shkollja Xhewdet Doda	m ²	1,000.00	0.39	390.00	5,850.00
9	Shkollja Dr. Ali Sokoli	m ²	500.00	0.39	195.00	2,925.00
10	Shkollja Sami Frasheri	m ²	500.00	0.39	195.00	2,925.00
11	Shkollja e mesme Medrese (Alaudin)	m ²	500.00	0.39	195.00	2,925.00
12	Çerdhja Vllakat	m ²	500.00	0.39	195.00	2,925.00
13	Çerdhja Dëllli	m ²	500.00	0.39	195.00	2,925.00
14	Çerdhja Fatosat	m ²	500.00	0.39	195.00	2,925.00
15	Çerdhja Gazimi Ynë	m ²	1,000.00	0.39	390.00	5,850.00
	Totali:		29,618.40		11,491.18	172,367.64

II. Paramasa e sipërfaqeve të jashtme						
N.r	Emri i objekteve Institucionale	Njësia	Sasia	Cmimi Njësia me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 24 muaj
1	Sipërfaqe të jashtme të gjetkësuar	m ²	21,449.50	0.09	1,930.46	28,956.88
2	Sipërfaqe të jashtme me asfalt	m ²	1,524.00	0.09	137.16	2,057.40
3	Sipërfaqe të jashtme beton dhe kubeza betoni	m ²	12,235.00	0.09	1,101.15	16,517.25
4	Fusha Sportive	m ²	3,429.90	0.09	308.69	4,630.37
	Totali		38,638.40		3,477.46	52,161.84

III. Paramasa e shpenzimeve higjienike						
	Materiali për Higjien për një muaj	Njësia	Sasia/muaj	Cmimi Njësia me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 24 muaj
1	Paloma kallore C(komplete)1/220	copë	300	€ 0.19	57.00 €	855.00 €
2	vinë 1 lagur 0.75 L	Copë	100	€ 0.16	16.00 €	240.00 €
3	Palom.rodit për WC 1/10	copë	300	€ 0.18	54.00 €	810.00 €
4	Shampon për duar 1 L	Lit	200	€ 0.19	26.00 €	390.00 €
5	Shampon për pastrimin e dyshtemeve të rendonrta	Lit/copë	280	€ 0.10	28.00 €	420.00 €
6	Domestos ose ekuvalent	Lit	150	€ 0.20	30.00 €	450.00 €
7	Thasë për mbeturina 120 Lit	Copë1/10	200	€ 0.01	2.00 €	30.00 €
8	Thasë për mbeturina 60 Lit	Copë1/10	150	€ 0.01	1.50 €	22.50 €
9	Arom për zyre	copë	100	€ 0.20	20.00 €	300.00 €
10	Shampoo për xham 0.75 L	Lit/copë	130	€ 0.13	16.90 €	253.50 €
11	klor (gusalec) për guac dhe lavaman	kg	35	€ 0.10	3.50 €	52.50 €
12	Shampon për dyshteme të tualetit	Lit/copë	200	€ 0.11	22.00 €	330.00 €
13	Dezodorant për fontane WC	copë	80	€ 0.19	14.40 €	216.00 €
14	Dispenser (aparati) me bateri për aroma ambientit (1x 36 muaj)	Copë	35	€ 0.01	0.35 €	5.25 €

Total i materialit per një muaj					291.65 €	4,374.75 €
--	--	--	--	--	-----------------	-------------------

REKAPITULLIMI I PERGJITHSHEM						
	Emri i objekteve Institucionale	Njësia	Sasia	Cmimi Njësia me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 24 muaj
1	I. Paramasa e sipërfaqeve të mbrendshme	m ²	29,618.40	0.39 €	11,551.18 €	172,367.64 €
2	II. Paramasa e sipërfaqeve të jashtme	m ²	38,638.40	0.09 €	3,477.46 €	52,161.84 €
3	III. Paramasa e shpenzimeve higjienike				291.65 €	4,374.75 €
						229,804.23 €



Nese e shiqojme me kujdes paramasen e plotesuar nga OE i rekomanduar per kontrate tek pjesa e pare - paramasa e siperfaqeve te mbrendshme totali per 1 muaj eshte 11,491.18 € ndersa per 15 muaj eshte cmimi 172,367.64 € ndersa Rekapitulin per kete pjese totalin per 1 muaj e ka dhene 11,551.18 € ndersa per 24 muaj e ka dhene 173,267.64 ku nese i shumezojme 11,551.18 € me 24 muaj atehere do te kemi shumen prej 227,228.32 € te cilen eshte dashur qe ta jep OE i rekomanduar per kontrate sipas paramases se dhene nga AK e qe shihet qarte se gabimi aritmetikore eshte me shume se 2%.

Gjithashtu edhe ne pjesen e dyte - paramasa e siperfaqeve te jashtme ku ne totalin per nje muaj ka dhene cmim prej 3,477.46 € ndersa ne totalin per 24 muaj ka dhene cmim prej 52,161.84 € ku nese i shumezojme cmimin per nje muaj 3,477.46 € me 24 muaj atehere fitojme cmimin prej 83,459.04 € te cilen eshte dashur qe ta jep OE i rekomanduar per kontrate sipas paramases se dhene nga AK e qe shihet qarte se gabimi aritmetikore eshte me shume se 2%.

Gjithashtu edhe tek pjesa e trete - paramasa e shpenzimeve hixhienike ku ne totalin per nje muaj ka dhene cmim prej 291.65 € ndersa ne totalin per 24 muaj ka dhene cmim prej 4,374.75 € ku nese i shumezojme cmimin per nje muaj 291.65 € me 24 muaj atehere fitojme cmimin prej 6,999.60 € te cilen eshte dashur qe ta jep OE i rekomanduar per kontrate sipas paramases se dhene nga AK e qe shihet qarte se gabimi aritmetikore eshte me shume se 2%.

Ketu shihet qarte se ky OE eshte i pa pergjegjshem.

Cmimet jo normalisht te uleta

GOE ka ofertuar me cmime jo normalisht te uleta tek materiali te cilat jane nga 0.01 cent ku nuk jane cmime te tregut dhe automatikisht ky GOE eshte dashur te eliminohet. Si shembull po marrim pozicionet ne pjesen e trete- paramasa e shpenzimeve higjienike - pozicionet 7, 8, 14 dhe te gjitha pozicione e tjera jane jo normalisht te uleta.

GOE i rekomanduar per kontrate nuk e ploteson as kerkesen e AK-se **Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 1.** Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë pastrim në vlerë minimale prej 300.000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë). *Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1.*

Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për

kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur ndersa GOE i rekomanduar per kontrate nuk ka prezantuar kontrata ne vleren e kerkuar dhe periudhen e kerkuar nga AK.

Certifikatat e punetoreve per siguri dhe shendet ne pune jane te nje kompanie tjeter e jo te GOE te cilet kane ofertuar ne kete tender

AK ka rekomanduar për kontrate një GOE te cilët nuk kane dorëzuar fare këto dokumente te cilat i ka kërkuar AK ne DT sipas pikës 11.1 Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik si ne vijim:

- a. **një deklaratë e qartë** ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës;

këtë deklaratë nuk e kane dorëzuar e cila është dashur te dorëzohet si e veçante dhe te deklarojnë qarte se të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.

- b. **një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët**, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

këtë deklaratë nuk e kane dorëzuar e cila është dashur te dorëzohet si e veçante duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit

- c. **një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit**;

këtë deklaratë nuk e kane dorëzuar e cila është dashur te dorëzohet si e veçante nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit

GOE i kane kopjuar me një VEND te gjitha këto shënime dhe i kane nënshkruar ne fund duke ja vendosur titullin: MARREVESHJE NE KONZORCIUM

Pra GOE është dashur ti dorëzoj tri deklarata te ndryshme veç e veç sipas kërkesës se DT-së dhe ti konfirmojne se ju permbahen atyre kushteve te atyre deklaratave pra te deklarohen lidhur me ato kushte e jo vetëm një marrëveshje. Shihet qarte se ky GOE është i pa përgjegjshëm dhe AK menjëherë eshte dashur ta eliminoj.

Per me tepër kjo eshte ne kundërshtim edhe me udhëzuesin e prokurimit publik neni 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së ku ne tablele eshte dhene si ne vijim:

Mungon deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	Kusht administrativ
Mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	Kusht administrativ
Mungon deklarata nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	Kusht administrativ

Neve ju kemi përmbajte kërkesave të AK-se të vendosura në NJK dhe DT andaj AK kundërligjshëm na ka eliminuar nga ky aktivitet të prokurimit.

Neve kemi ofertuar me tender të përgjegjshëm dhe me Çmimin ekonomikisht me të favorshëm. Me këtë veprim AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së ku thuhet se: *vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.*

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu shihet qartë se AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së ku në pikën 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Si dhe në pikën 2 thuhet :

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

AK për këtë aktivitet të prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa që duhet shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të Prokurimit andaj, Kërkojmë nga AK që ti respektoj në përpikëri dispozitat ligjore që janë në fuqi lidhur me këtë lloj të aktivitetit të prokurimit dhe të nxjerr:

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës për rishqyrtim

Autoriteti Kontraktues duke respektuar nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, në respektim të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik si dhe dispozitat e Rregullores për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik ka bërë vlerësimin e ofertave dhe në harmoni me kriteret e dosjes së tenderit.

Operatori Ekonomik BENI shpk nuk ka plotësuar përshkrimin e çmimeve si në vijim:

I. Paramasa e siperfaqeve të mbrendshme						
	Emri i objekteve institucionale	Njësia	Sasia	Cmimi Njesi me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 15 muaj
1	Shkolla Abdyl Frasheri	m ²	2,850.00	0.6	1,710.00	25,650.00
2	Shkolla 7 Shtatori	m ²	1,000.00	0.6	600.00	9,000.00
3	Shkolla Prenk Jakova	m ²	2,540.00	0.6	1,524.00	22,860.00
4	Shkolla Eqrem Qabej	m ²	6,778.40	0.6	4,067.04	61,005.60
5	Shkolla Hoxhe Kadri Prishtina	m ²	5,400.00	0.6	3,240.00	48,600.00
6	Shkolla Gjimazi Matematikor	m ²	4,550.00	0.6	2,730.00	40,950.00
7	Shkolla 28 Nentori	m ²	1,500.00	0.6	900.00	13,500.00
8	Shkolla Xhevdet Doda	m ²	1,000.00	0.6	600.00	9,000.00
9	Shkolla Dr.Ali Sokoli	m ²	500.00	0.6	300.00	4,500.00
10	Shkolla Sami Frasheri	m ²	500.00	0.6	300.00	4,500.00
11	Shkolla e mesme Medrese (Alaudin)	m ²	500.00	0.6	300.00	4,500.00
12	Çerdhja Yllkat	m ²	500.00	0.6	300.00	4,500.00
13	Çerdhja Dielli	m ²	500.00	0.6	300.00	4,500.00
14	Çerdhja Fatosat	m ²	500.00	0.6	300.00	4,500.00
15	Çerdhja Gëzimi Ynë	m ²	1,000.00	0.6	600.00	9,000.00
	Totali:		29,618.40		600.00	9,000.00
						266,565.60

II. Paramasa e sipërfaqeve të jashtme						
N.r	Emri i objekteve institucionale	Njësia	Sasia	Cmimi Njesi me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 24 muaj

1	Siperfaqe te jashtme te gjelbruara	m ²	21,449.50	0.06	1,286.97	
2	Siperfaqe te jashtme me asfalt	m ²	1,524.00	0.06	91.44	
3	Siperfaqe te jashtme beton dhe kubeza betoni	m ²	12,235.00	0.06	734.10	
4	Fusha Sportive	m ²	3,429.90	0.06	205.79	
	Totali		38,638.40			

III. Paramasa e shpenzimeve higjenike

	Materiali për Higjen për një muaj	Njësia	Sasia/muaj	Cmimi Njesi me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 24 muaj
1	Paloma katrore C(komplete)1/220	copë	300			
2	vim i lagur 0.75 L	Cope	100			
3	Palom role për WC 1/10	copë	300			
4	Shampon për duar 1 L	Lit	200			
5	Shampon per pastrimin e dysHEMEVE te rendomta	Lit/cope	280			
6	Domestos ose ekuivalent	Lit	150			
7	Thasë për mbeturina 120 Lit	Copë1/10	200			
8	Thasë për mbeturina 60 Lit	Copë1/10	150			
9	Arom për zyre	copë	100			
10	Shampon për xhama 0.75 L	Lit/cope	130			
11	klor (guralec) per guac dhe lavaman	kg	35			
12	Shampon per dysHEME te tualetit	Lit/cope	200			
13	Dezodorant per fontane wC	copë	80			
14	Dispenser (aparati) me bateri per aroma ambienti (1X 36 muaj)	Cope	35			
	Total i materialit per nje muaj					

REKAPITULLIMI I PERGJITHSHEM

	Emri i objekteve institucionale	Njësia	Sasia	Cmimi Njesi me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 24 muaj
1	I. Paramasa e siperfaqeve të mbrendshme	m ²	29,618.40			
2	II. Paramasa e sipërfaqeve të jashtme	m ²	38,638.40			
3	III. Paramasa e shpenzimeve higjenike					

Shihet qartë që OE ankimor BENI shpk në shumicën e pozicioneve nuk ka vendosur fare çmim edhe pse totali i çmimit për sasi ka qenë për 15 muaj kohë aq sa ka qenë kohëzgjatja e kontratës në dosje të tenderit. Mungon Përshkrimi i çmimit refuzo tenderin pa kërkuar sqarim.

Operatori Ekonomik ankimor ka paraqitur pretendimet ankimore dhe në pretendimin e parë ka theksuar se nuk është kërkuar deklaratë për përmbushjen e shpeshtësisë së pastrimit tek kriteri i dhënies së kontratës i cili ka qenë kriter ekonomikisht më i favorshëm.

Sa i përket pretendimit 4: Operatori Ekonomik ankimor BENI shpk nuk ka dorëzuar deklaratë të garancionit dhe deklaratë të mirëmbajtjes të cilat janë kriteret obligative të përmbushjes që janë kriteret e dhënies për tenderin ekonomikisht të favorshëm. Dosja e tenderit ka specifikuar qartë kriterin e dhënies Ekonomikisht të favorshëm si në vijim:

Kriteret e dhënies së kontratës

Kategoritë		Përshkrimi i kriterëve	Pesha	Metoda e Vlerësimit
1	Çmimi	Pikët <100x70 %> për tenderin me çmimin më të ulët. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	70%	$P = \frac{P_s}{P_t} \times [100x\%]$
	Operimi (shpeshtësia e pastrimit të sipërfaqeve sipas paramasës) min. 1 herë max 3 herë	Pikët <100x 30%> për tenderin me shpeshtësinë më të madhe të pastrimit. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht		
			100 %	

Ps – Çmimi më i ulët;

Pt – Çmimi i tenderit.

Ds – shpeshtësia e pastrimit e tenderuesit;

Dt – shpeshtësia më e madhe e pastrimit

Sipas nenit 27 të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022:

Neni 27 par.7 – Kriteri i dhënies së kontratës:

27.7 Kur bëhet dhënia e kontratës në bazë të kriterit “tenderi ekonomikisht më i favorshëm”, dosja e tenderit dhe, nëse aplikohet, njoftimi për kontratë duhet të deklarojë të gjitha kriteret (në një mënyrë objektive dhe të matshme) që aplikohet në procesin e dhënies, dhënia e

peshëve relative (në kushte monetare) të përcaktuara për secilin kriter. Ato duhet të paravendosen dhe të bëhen të ditura për tenderuesit. Kriteria të reja ose të amandamentuara nuk duhet të prezantohet gjatë procedurës së dhënies së kontratës. Nëse autoriteti kontraktues gjatë procedurës së prokurimit kupton që kriteret e përdorura janë të papërshtatshme për të përcaktuar tenderin ekonomikisht më të favorshëm, përmirësimi i vetëm i situatës është anulimi i procedurës dhe tenderit.

27.8 Është obligim i Departamentit/ Njesisë së Prokurimit/ të siguroj që blerja më e mirë (vlera ekonomikisht më e favorshme) të sigurohet duke marrur parasysh kombinimin optimal të kostos, të cilat do të përfshijë kostot totale të ciklit të jetës së mallrave, punëve ose shërbimeve. Është e nevojshme të shikohen të gjitha kostot që do të kontribuojnë kostot e mirëmbajtjes dhe kostot Operative të projektit që do të jenë të arsyeshme, gjatë jetë gjatësisë së projektit. Nuk është vetëm kostoja e artikujve, mallrave ose shërbimeve në tender, por përfshirja e të gjitha kostove, direkte dhe indirekte, siç janë:

Kostoja e artikujve + Kostot operative

Kosto e artikullit + Kostot e artikujve të shpenzueshëm (artikujt e përdorur me pajisje)

Kosto e artikullit + Kostot funksionale (kostot Operative)

Kosto e artikullit + Resurset njerëzore të përfshira (kostot e fuqisë punëtore)

Kosto e artikullit + Kostoja e listës së pjesëve rezervë të rekomanduara

Kosto e artikullit + Kostot e mirëmbajtjes / kostot e servisimeve (javore, mujore)

Kosto e artikullit + Kostot e riparimit

Kosto e artikullit + përfshira e kostove të qirasë ose lizingut

Kosto e artikullit + Sigurimi

Kosto e artikullit + Konsideratat për ndikimin në mjedis

Kosto e artikullit + Konsideratat shëndetësore dhe të sigurisë.

27.9 Tenderët duhet të vlerësohen objektivisht dhe në mënyrë transparente krahas kriterëve të peshuara të publikuara. Objektiviteti dhe transparenca arrihet në mënyrën më të mirë me përdorimin e sistemit të vlerësimit me pikë ose shënimeve të pikëve të vlerësuara bazuar në kriteret e peshuara, që tregojnë një vlerësim krahasues të tenderëve nën secilin kriter.

**DEKLARAT PER PASTRIMIN SIPAS KËRKESAVE TË ANEKS 1 PËR SHPESHTËSIN E
PASTRIMIT**

Operimi (shpeshtësia e pastrimit të sipërfaqeve sipas paramasës) min. 1 herë max 3 herë	Pikët <100x 30%> për tenderin me shpeshtësinë më të madhe të pastrimit. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	30%	$D = \frac{D_s}{D_t} \times [100x\%]$
---	--	-----	---------------------------------------

Kompania jonë deklaron se sipas kërkesës së dhënë në ANKES 1 do të brenda orarit të zyrtarë duke angazhuar numrin e punërëve sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Grupet e punëtorëve të anagazhuar në të gjitha hapsirat e kërkesave të dosjes, brenda në orarin e punës do të pastrojm 4 herë duke e ndarë sipas orit të ditës prej:

Ora 07:00 deri në orën 8:00

Ora 10:00 deri në orën 12:00

Ora 12:00 deri në orën 14:00

Ora 14:00 deri në orën 16:00

Si dhe të shtunën pastrimin general të hapsirave të brendshme kompania jonë do të angazhoj ekipet e kompanisë që punojn në kuander të kompanisë pa kosto shtes për AK. Ekipet mobile të cilat kompania jonë i ka të angazhuara.

Të shtunën në orarin e punës prej orës 8:00 deri në ora 16:00

Në afatin prej 3 ditësh nese kompania jonë do të shpallej fitus do të prezantojm metodologjin e punës lidhur me implementimin e kontratës në tërësi.


 E Commerce Kosova Sh.p.k
 Meriton Bjarani
 Prishtinë

Sa i përket pretendimet të dytë OE ankimor ka paraqitur se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka plotësuar kriterin e dosjes së tenderit lidhur me konzorciumin e grupit të operatorëve ekonomik AK ju paraqet marrëveshjen e konzorciumit të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës si në vijim:

**MARRËVESHJE NË KONZORCIUM
NDËRMJET**

1. Kompania "E-Commerce – Kosova SH.P.K", me numër të biznesit 810832726 me adresë Rr. "Luan Haradinaj " nr. 10/2 Prishtinë
2. Kompania N.SH.H. "ZONA PARK " me numër të biznesit 70786214, Adresa Parku i Qytetit - Prizren

E lidhur në Prishtinë më 20.03.2023

Marrëveshje e lidhur për shpallëjen publike nga KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES me date: 09.02.2023

Titulli: Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës, me Numër i prokurimit: 616-23-781-2-1-1.

Kompanit në konzorcium arrin marrëveshje në mbështetje profesionale dhe ligjore sipas kërkesave të lejuara në parimet e punës, si dhe rregullave ligjore të Ligjit mbi Prokurim Publik, deklarojmë se e mbështesim kompanin "E-Commerce – Kosova SH.P.K" të dhënat në piken (1), lidhur më të gjitha kërkesat e ligjore, profesionale dhe teknike. Duke deklaruar për pikat (a), (b), (c), (d), (e).

- a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës;
- b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;
- c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit;

(autorizimi i është dhënë kompanisë “E-Commerce – Kosova SH.P.K” lidere e grupit në konzorcium).

- d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.
- e. Se cili anëtar i grupit të Operatoreve ekonomik duhet të regjistrohet në platformën elektronike

Antarët e konzorciumit:

“E-Commerce – Kosova SH.P.K”
Meriton Bajcami / Drejtor



N.SH.H. “ZONA PARK”
Besnik Hoti / Drejtor



Autoriteti Publik vlerëson që janë përmbushur të gjitha pikat që kërkohen sipas dispozitave të LPP-së dhe RRUOPP-së lidhur me marrëveshjen për krijimin e grupit të operatorëve ekonomik.

Sa i përket pretendimet të tretë lidhur me atë se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e ka plotësuar përshkrimin e çmimit në pozicionin si në vijim nuk ndikon në gabime aritmetike në asnjë mënyrë për arsye se është dhënë çmim njësi për 15 muaj ashtu siç është specifikuar në dosje të tenderit dhe nuk ka të bëjë me kalkulimin e çmimit për 24 muaj, pasi që kohëzgjatja e kontratës sipas dosjes së tenderit dhe vlerës së parashikuar është 15 muaj dhe kalkulimi i çmimeve për sasi nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është për kohëzgjatje për 15 muaj i cili ka paraqitur përshkrimin e çmimit si në vijim:

PARAMASA: SHËRBIMET E PASTRIMIT TË OBJEKTEVE , ARSIMORE (HAPASIRAT E BRENDSHME DHE TË JASHTME) KONTRATË KORNIZË						
I. Paramasa e sipërfaqeve të mbrendshme						
	Emri i objekteve institucionale	Njësia	Sasia	Cmimi Njesi me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 15 muaj
1	Shkolla Abdyl Frasheri	m ²	2,850.00	0.39	1,111.50	16,672.50
2	Shkolla 7 Shtatori	m ²	1,000.00	0.39	390.00	5,850.00
3	Shkolla Prenk Jakova	m ²	2,540.00	0.39	990.60	14,859.00
4	Shkolla Eqrem Qabej	m ²	6,778.40	0.39	2,643.58	39,653.64
5	Shkolla Hoxhe Kadri Prishtina	m ²	5,400.00	0.39	2,106.00	31,590.00
6	Shkolla Gjimezi Matematikor	m ²	4,550.00	0.39	1,774.50	26,617.50
7	Shkolla 28 Nentori	m ²	1,500.00	0.39	585.00	8,775.00
8	Shkolla Xhevdet Doda	m ²	1,000.00	0.39	390.00	5,850.00
9	Shkolla Dr.Ali Sokoli	m ²	500.00	0.39	195.00	2,925.00
10	Shkolla Sami Frasheri	m ²	500.00	0.39	195.00	2,925.00
11	Shkolla e mesme Medrese (Alaudin)	m ²	500.00	0.39	195.00	2,925.00
12	Çerdhja Vllket	m ²	500.00	0.39	195.00	2,925.00
13	Çerdhja Dielli	m ²	500.00	0.39	195.00	2,925.00
14	Çerdhja Fatosat	m ²	500.00	0.39	195.00	2,925.00
15	Çerdhja Gëzimi Ynë	m ²	1,000.00	0.39	390.00	5,850.00
	Totali:		29,618.40	0.33	11,491.18	172,367.64
II. Paramasa e sipërfaqeve të jashtme						
N.r	Emri i objekteve institucionale	Njësia	Sasia	Cmimi Njesi me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 24 muaj
1	Sipërfaqe te jashtme te gjelbruara	m ²	21,449.50	0.09	1,930.46	28,956.83
2	Sipërfaqe te jashtme me asfalt	m ²	1,524.00	0.09	137.16	2,057.40
3	Sipërfaqe te jashtme beton dhe kubeza beton	m ²	12,235.00	0.09	1,101.15	16,517.25
4	Fusha Sportive	m ²	3,429.90	0.09	308.69	4,630.37
	Totali		38,638.40		3,477.46	52,161.84
III. Paramasa e shpenzimeve higjienike						
	Materiali për Higjen për një muaj	Njësia	Sasia/muaj	Cmimi Njesi me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 24 muaj
1	Paloma katrorë C(komplete)1/220	copë	300	€ 0.19	57.00 €	855.00 €
2	vim I lagur 0.75 l	Cope	100	€ 0.16	16.00 €	240.00 €
3	Palom role për WC 1/10	copë	300	€ 0.18	54.00 €	810.00 €
4	Shampon për duar 1 l	Lit	200	€ 0.13	26.00 €	390.00 €
5	Shampon për pastrimin e dysheveve te rendoms	Lit/cope	280	€ 0.10	28.00 €	420.00 €
6	Domestos ose ekuivalent	Lit	150	€ 0.20	30.00 €	450.00 €
7	Thasë për mbeturina 120 Lit	Copë1/10	200	€ 0.01	2.00 €	30.00 €
8	Thasë për mbeturina 60 Lit	Copë1/10	150	€ 0.01	1.50 €	22.50 €
9	Arom për zyre	copë	100	€ 0.20	20.00 €	300.00 €
10	Shampon për xhama 0.75 L	Lit/cope	130	€ 0.13	16.90 €	253.50 €
11	klor (guralet) per guac dhe lavaman	kg	35	€ 0.10	3.50 €	52.50 €
12	Shampon per dysheve te tualetit	Lit/cope	200	€ 0.11	22.00 €	330.00 €
13	Dezodorant per fontane wC	copë	80	€ 0.19	14.40 €	216.00 €
14	Dispenser (aparati) me bateri per aroma ambienti (1X 36 muaj)	Cope	35	€ 0.01	0.35 €	5.25 €

Total i materialit per nje muaj				291.65 €	4,374.75 €
---------------------------------	--	--	--	----------	------------

REKAPITULLIMI I PERGJITHSHEM					
Emri i objekteve institucionale	Njësia	Sasia	Cmimi Njesi me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 24 muaj
1 I. Paramasa e sipërfaqeve të mbrendshme	m ²	29,618.40	0.39 €	11,551.18 €	173,267.64 €
2 II. Paramasa e sipërfaqeve të jashtme	m ²	38,638.40	0.09 €	3,477.46 €	52,161.84 €
3 III. Paramasa e shpenzimeve higjenike				291.65 €	4,374.75 €
					229,804.23 €



Ndërsa sa i përket pretendimet ankimor se OE i rekomanduar nuk ka kontrata të realizuara sipas kërkesës së dosjes së tenderit, Autoriteti Publik vlerëson që në bazë të nenit 59 si dhe në respektim të dispozitës së nenit 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës plotëson kriteret e dosjes së tenderit në pikën 9.1 dhe 9.2 si në vijim:

ZONA PARK

TEL: +383 29 222 441

TEL: +383 29 210 999

www.zonapark-ks.com

Email: prokurimi@zonapark-ks.com

LISTA E KONTRATAVE PËR SHËRBIME HIXHENIKE

Lista e kontratave për shërbimet e realizuara
përgjatë tri (3) viteve të fundit

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Titulli i Kontratës	Punët e përfshira	Shuma dhe Data	Pranuesi
1	Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"	Pastrimi, mirëmbajtja - Dezinsektim, Dezinsektim dhe Deratizim	Pastrim dhe mirëmbajtje të kapusit univeristar aneks kontratë	24.04.2019 164,994.72 €	Bajram Kolged
2	Komuna e Rahovecit	Pastrimi dhe mirëmbajtja hixhenike e objekteve të Komunës së Rahovecit	Pastrim dhe mirëmbajtje të hixhienës kontratë kornizë 24 mujore	10.07.2019 250,000.00 €	Astrit Mullabazi
3	Komuna e Rahovecit	Pastrimi dhe mirëmbajtja hixhenike e objekteve të Komunës së Rahovecit	Pastrim dhe mirëmbajtje të hixhienës kontratë 3 mujore	23.08.2021 50,000.00 €	Astrit Mullabazi
4	Komuna e Rahovecit	Pastrimi dhe mirëmbajtja hixhenike e objekteve të Komunës së Rahovecit	Pastrim dhe mirëmbajtje të hixhienës kontratë kornizë 24 mujore	23.08.2021 250,000.00 €	Astrit Mullabazi
5	Komuna e Prizrenit	Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit dhe zonave periferike	Dezinsektim	21.12.2020 79,980.00 €	Isa Osmankaj
6	Komuna e Prizrenit	Mirëmbajtja e objekteve të Komunës së Prizrenit	Deratizim Pastrim dhe mirëmbajtje të hixhienës kontratë kornizë 24 mujore	27.08.2020 361,560.00 €	Isa Osmankaj

Lista e Kontratave | Zona Park – Parku i Qytetit, 20 000, Prizren, Kosovë

7	Komuna e Ferizajit	Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve	Pastrim dhe mirëmbajtje të hixhienës kontratë kornizë 24 muajore	26.12.2018 249,680.00 €	Fehmi Reka
8	Komuna e Fushë Kosovës	Dezinsektim, Dezinfektim dhe Deratizim i objekteve arsimore, shëndetësore dhe hapësirave publike	Dezinsektim Dezinsektim Deratizim	17.12.2020 69,800.00 €	Bedri Obertinca
9	Spitali i Përgjithshëm Prizren	Dezinsektim, Dezinfektim dhe Deratizimi emergjent të objekteve të Spitalit	Dezinsektim Dezinsektim Deratizim	16.12.2020 8,360.00 €	Samir Ahmetaj
10	Komuna e Fushë Kosovës	Dezinsektimi dhe Deratizimi	Dezinsektim Deratizim	12.02.2019 11,600.00 €	Bedri Obertinca
11	Agjencia për Krahësim dhe Verifikim të Pronës	Dezinsektim Dezinsektim dhe Deratizim i objektit të ZR-Prishtinë	Dezinsektim Dezinsektim Deratizim	17.06.2019 491.20 €	Dukagjin Ramadani
12	Komuna e Malishevës	Spërkatja nga toka e zonave endemike nga Etnet Hemorragjike	Dezinsektim	26.06.2019 52,000.00 €	Nuhi Shala
13	Komuna e Malishevës	Dezinsektimi i hapësirave ku ndodhen të infektuarit me COVID-19	Dezinsektimi	10.12.2020 14,942.00 €	Nuhi Shala
14	Spitali i Përgjithshëm Prizren	Dezinsektimi i repartit të Hemodializës dhe Infektivës ku ndodhen të infektuarit me COVID-19	Dezinsektim	16.12.2020 980.00 €	Samir Ahmetaj
Totali i Punëve të Realizuara				1,607,353.80 €	

Nënshkrimi

Besnik Hoti



Drejtori: Besnik Hoti

2


Lista e Kontratave | Zona Park – Parku i Qytetit, 20 000, Prizren, Kosovë

Andaj në bazë të asaj që është lartcekur autoriteti publik vendos si në dispozitiv.

Iu dorëzohet:

Departamentit të Prokurimit
Palës përmes sistemit elektronik - E-Prokurimi
Arkivit

Visar Shehu - U.D. - Departamenti i Prokurimit

A circular official stamp of the Kosovo Prosecutorial Office (Prokurimi i Kosovës) is visible. The stamp contains the text "PROKURIMI I KOSOVËS" and "DREKTORATI I PROKURIMIT". A handwritten signature in blue ink, which appears to be "Visar Shehu", is written over the stamp. A horizontal line is drawn across the signature.